



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2304/12 prot.

Datë 22.10.2025

V E N D I M

Nr. 1516/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. **1409/2025**, datë 08.10.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

Ankimues:

Operatori ekonomik “One Albania” SHA me NIPT J61814094W dhe adresë: adresë Njesia Bashkiake Nr.11, Rruga Vangjel Noti, Ndertesa Nr.20, 1026, Laprakë, Tiranë.

Operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK me NIPT K72223007O dhe adresë Njesia bashkiake nr 5, rruga Pjeter Bogdani, godina nr 3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Posta Shqiptare me adresë Rr.“Reshit Çollaku”, Nr., 4, Tiranë

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Abissnet” SHA me NIPT K01417001C dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Ismail Qemali, Pallati 18, Kati II, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 08.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. **1409/2025**, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “One Albania” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.*
2. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.*
6. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 843/33 prot., datë 16.10.2025 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik

ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 2304/9 prot., datë 17.10.2025, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka informuar KPP se: “[..] ju informojmë se në zbatim të vendimit nr. 1409, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka ngritur urdhrin e brendshëm për rivlerësimin e ofertave dhe ka kthyer fazën e procedurës për rivlerësim në SPE.” Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar: Urdhrin e brendshëm për rivlerësim ofertash nr. 5/32, datë 13.10.2025, si dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave datë 15.10.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr. 843/33 prot., datë 16.10.2025 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 2304/9 prot., datë 17.10.2025, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka informuar KPP se: “[..] ju informojmë se në zbatim të vendimit nr. 1409, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka ngritur urdhrin e brendshëm për rivlerësimin e ofertave dhe ka kthyer fazën e procedurës për rivlerësim në SPE.” Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar: Urdhrin e brendshëm për rivlerësim ofertash nr. 5/32, datë 13.10.2025, si dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave datë 15.10.2025.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, si dhe nga verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me konstatimet e vendimit nr. 1409/2025, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër arsyetuar autoriteti kontraktor të reflektojë në SPE rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1409/2025, datë 08.10.2025.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind

e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin nr. 1409/2025, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

